

Njoftimi i NYC Health + Hospitals për praktikat e privatësisë

Ky Njoftim për praktikat e privatësisë (Notice of Privacy Practices, "NPP") përshkruan se si mund të përdoren dhe zbulohen informacionet tuaja mjekësore dhe informacionet për trajtimin e çrregullimeve të përdorimit të substancave (substance use disorder, SUD) dhe si mund të keni akses në këto informacione; të drejtat tuaja në lidhje me informacionet tuaja shëndetësore; si të paraqisni një ankesë në lidhje me një shkelje të privatësisë ose sigurisë së informacioneve tuaja shëndetësore; ose të të drejtave tuaja në lidhje me informacionet tuaja dhe si mund të keni akses në këto informacione.

Ju keni të drejtë të merrni një kopje të këtij njoftimi në letër ose në mënyrë elektronike dhe ta diskutoni atë me Zyrën e Pajtuëshmërisë të Korporatës, Përgjegjësin për Privatësinë dhe Sigurinë të Korporatës me anë të email-it në adresën CPO@nychhc.org.

Ju lutemi lexojeni me kujdes.

Prezantimi dhe Informacioni

New York City Health and Hospitals Corporation, e njohur edhe si "NYC Health + Hospitals" ose "Sistemi", është e detyruar sipas ligjit federal, specifikisht sipas Ligjit për portabilitetin dhe llogaridhënien për sigurimet shëndetësore të vitit 1996 (Health Insurance Portability and Accountability Act, "HIPAA") dhe Pjesës 2, titullit 42 të Kodit të Rregulloreve Federale (Code of Federal Regulations, CFR), që të ruajë privatësinë e informacioneve tuaja të mbrojtura shëndetësore, gjë që përfshin dhënien e një njoftimi për detyrat e saj ligjore dhe praktikat e privatësisë, duke përfshirë detyrimin për t'ju njoftuar në rast të shkeljes së të dhënave të pasigurta, si dhe të një përshkrimi për llojet e informacioneve që mbledhim rreth jush, me kë mund të ndahen këto informacione dhe të drejtat tuaja. Në këtë njoftim NPP përshkruhen masat mbrojtëse për privatësinë tuaj dhe të drejta të tjera që lidhen me informacionet tuaja shëndetësore sipas ligjit HIPAA dhe rregullores Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së. Ju mund të përfitoni mbrojtje dhe të drejta shtesë sipas ligjeve të tjera Federale dhe / ose ligjit të Shtetit që nuk përshkruhen në këtë NPP. Sistemi kërkohet të ndjekë kushtet për njoftimin që është aktualisht në fuqi.

Shprehja "informacion shëndetësor", siç përdoret në këtë NPP, i referohet çdo informacioni personalisht të identifikueshëm, i cili krijohet, pranohet, mirëmbahet ose transmetohet nga Sistemi, dhe që ka të bëjë me kujdesin dhe trajtimin tuaj shëndetësor si dhe pagesa për një kujdes dhe trajtim të tillë.

Informacionet për trajtimin e çrregullimeve të përdorimit të substancave (SUD), siç përdoret në këtë njoftim NPP, është një lloj informacioni shëndetësor që merr mbrojtje shtesë në kuadër të rregulloreve federale (Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së).

Mbrojtjet shtesë të privatësisë, të cilat nuk përcaktohen në këtë njoftim NPP, mund të zbatohen për informacionet shëndetësore në lidhje me virusin HIV, informacionet për shëndetin mendor dhe informacionet gjenetike ose për testimin gjenetik.

Në këtë njoftim NPP përshkruhen praktikat e privatësisë që duhet të ndiqen në të gjitha qendrat, njësitë dhe entitetet e NYC Health + Hospitals, duke përfshirë të gjitha spitalet e kujdesit akut dhe klinikat

përkatëse; të gjitha qendrat diagnostikuese dhe të trajtimit të Gotham Health dhe qendrat shëndetësore përkatëse të lagjeve; të gjitha qendrat e kujdesit akut afatgjatë dhe qendrat e infermierisë së specializuar; si dhe të gjitha shërbimet dhe programet e ofruara në shtëpi dhe në komunitet.

NYC Health + Hospitals rezervon të drejtën të rishikojë këtë NPP. NYC Health + Hospitals rezervon të drejtën për ta zbatuar njoftimin e rishikuar NPP për informacionet shëndetësore dhe informacionet për trajtimin e çrregullimeve SUD që janë tashmë të ruajtura, si dhe për informacionet shëndetësore dhe informacionet për trajtimin e çrregullimeve SUD që do të merren në të ardhmen. NYC Health + Hospitals do të postojë një kopje të NPP aktual (me një datë të caktuar hyrjeje në fuqi) në vendndodhje të dukshme në qendrat, njësitë dhe entitetet e saj, dhe në faqen e saj publike.

Përdorimet dhe zbulimet e informacioneve shëndetësore për operacionet e trajtimit, pagesat dhe kujdesin shëndetësor

Trajtimi. Sistemi mund të përdorë dhe zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për t'ju ofruar trajtim, kujdes ose shërbime mjekësore, dhe mund t'ua zbulojë informacionet tuaja shëndetësore ofruesve të kujdesit shëndetësor ose punonjësve të tjerë që janë të përfshirë në kujdesin tuaj. Departamente të ndryshme të një spitali gjithashtu mund të ndajnë informacionet tuaja shëndetësore për të koordinuar shërbimet e ndryshme të kujdesit shëndetësor që ju nevojiten, siç janë recetat, analizat laboratorike dhe grafitë. Kur është e nevojshme, Sistemi gjithashtu mund të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për personat jashtë Sistemit të cilët mund të jenë të përfshirë në përkujdesjen tuaj. *Për shembull: Një mjek që po ju trajton për një këmbë të thyer mund të duhet të dijë nga një mjek tjetër nëse keni diabet sepse diabeti mund të ngadalësojë procesin e shërimit dhe ata duhet të ofrojnë shërbime të përshtatshme.*

Pagesa. Sistemi mund të përdorë dhe të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për të marrë pagesa për shërbimet dhe përkujdesjen tuaj shëndetësore. Sistemi mund të përdorë dhe të zbulojë informacionet shëndetësore në planin tuaj shëndetësor në lidhje me një trajtim ose procedurë që do të merrni për të marrë miratimin paraprak ose për të përcaktuar nëse plani juaj do ta mbulojë atë. Për kujdesin shëndetësor ose shërbimet e paguara plotësisht nga ju, mund të kërkonit që Sistemi të kufizojë informacionin shëndetësor të ndarë me kompaninë tuaj të sigurimeve, në masën e lejuar me ligj. *Për shembull: Sistemi mund të ketë nevojë të japë informacione për planin tuaj shëndetësor për procedurat kirurgjikale ndaj të cilave jeni nënshtruar në NYC Health + Hospitals, në mënyrë që plani juaj shëndetësor të paguajë Sistemin ose t'ju rimbursojë për procedura të tilla.*

Operacionet shëndetësore. Sistemi mund të përdorë dhe të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për të kryer operacione në baza ditore dhe për t'u siguruar që pacientët e NYC Health + Hospitals marrin një kujdes cilësor. Sistemi gjithashtu mund të kombinojë informacionin shëndetësor për shumë pacientë për të kryer statistika ose analiza për të përcaktuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e shërbimeve të ofruara. Kur është e nevojshme, Sistemi gjithashtu mund të zbulojë informacione shëndetësore për llogaritarët e kontraktuar, konsulentët dhe profesionistët e tjerë që mbështesin funksionimin e programeve, njësive dhe qendrave të ndryshme. *Për shembull: Sistemi mund të përdorë informacionet tuaja shëndetësore për të rishikuar cilësinë e trajtimit dhe shërbimeve që ai ofron.*

Kujtesa për takimet. Sistemi mund të përdorë dhe të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për t'ju kontaktuar me përkujtuesit që t'ju kujtojnë se keni një takim në një strukturë, njësi ose qendër.

SHËNIM: Pëlqimi me shkrim është i domosdoshëm për zbulimin e informacioneve të trajtimit të çrregullimeve SUD për qëllime të operacioneve të trajtimit, të pagesave dhe të kujdesit shëndetësor.

Përdorimet dhe zbulimet e informacioneve shëndetësore kur autorizimi kërkohet

NYC Health + Hospitals duhet të marrin autorizimin tuaj me shkrim para se të përdorë ose të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore në situatat e mëposhtme:

Marketing. Sistemi duhet të marrë autorizimin tuaj me shkrim para se të mund të përdorë informacionet tuaja shëndetësore për të komunikuar me ju në lidhje me blerjen ose përdorimin e një produkti ose shërbimi, përveç rasteve kur komunikimi kryhet ballë për ballë midis ju dhe Sistemit, ose përbëhet nga një dhuratë promovuese me vlerë nominale i cili ju jepet nga Sistemi. Sidoqoftë, situatat e mëposhtme nuk kërkojnë autorizim me shkrim paraprak, përveç rastit kur Sistemi merr pagesa nga një palë e tretë në këmbim të komunikimit me ju: (i) përfitime dhe shërbime që lidhen me shëndetin; (ii) Informacione për ilaçet; dhe (iii) alternativat e trajtimit.

Shitja e informacionit shëndetësor. NYC Health + Hospitals nuk do të shesin informacionet tuaja shëndetësore pa autorizim me shkrim.

Përdorimet dhe zbulimet e informacioneve shëndetësore kur autorizimi nuk kërkohet

NYC Health + Hospitals nuk ka nevojë të marrë autorizimin tuaj me shkrim përpara se të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore në situatat e mëposhtme.

SHËNIM: Përdorimet dhe zbulimi i informacioneve për trajtimin e çrregullimeve SUD në situatat e mëposhtme mund të kërkojnë pëlqimin tuaj me shkrim sipas rregullores Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së.

Drejtoria e qendrës. Sistemi mund të përdorë informacione të caktuara shëndetësore në lidhje me ju në drejtorinë e qendrës në spital ndërkohë që jeni shtruar në spital. Këto informacione shëndetësore mund të përfshijnë emrin, vendndodhjen në qendër, gjendjen tuaj të përgjithshme dhe përkatësinë tuaj fetare. *Shënim:* Vetëm anëtarëve të klerit ose anëtarëve të forcës punëtore të klerit do t'u zbulohet përkatësia juaj fetare. Nëse preferoni që Sistemi të mos i përfshijë këto informacione shëndetësore në drejtorinë e qendrës, ju keni të drejtë të kundërshtoni përfshirjen e informacioneve të tilla, dhe mund ta bëni këtë duke kontaktuar Departamentin e Pranimi ose Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor të qendrës.

Aktivitetet e mbledhjes së fondeve. Sistemi mund të përdorë ose të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për t'ju kontaktuar me qëllim mbledhjen e fondeve për njësitë e Sistemit dhe operacionet shëndetësore. NYC Health + Hospitals gjithashtu mund të ndajë informacionet tuaja shëndetësore me një fondacion të lidhur me Sistemin ose bashkëpunëtorin e biznesit për të njëjtat qëllime. Për t'u tërhequr nga marrja e këtij lloj komunikimi, mund të dërgoni një kërkesë me shkrim me email në adresën optoutforfundraising@nychhc.org. Juve nuk mund t'ju mohohet trajtimi, ose çdo lloj përfitimi ose shërbimi tjetër nëse zgjidhni të mos merrni komunikime për mbledhjen e fondeve.

Kërkim. Nëse merrni pjesë në një testim klinik, NYC Health + Hospitals do të kërkojnë lejen tuaj me shkrim përpara se të përdorë ose ndajë informacionet tuaja shëndetësore. Në rrethana të caktuara, Sistemi mund të përdorë informacionet tuaja shëndetësore pa lejen tuaj me shkrim për një studim hulumtues pas kryerjes së një procesi të veçantë të miratimit që siguron rrezik minimal për privatësinë tuaj. Në asnjë rrethanë një studiues nuk do të zbulojë emrin ose identitetin tuaj publikisht në përgatitje e sipër, përgjatë ose pas një studimi hulumtues.

Individët e përfshirë në përkujdesjen tuaj ose në pagesën për përkujdesjen tuaj. Në qoftë se nuk kundërshtoni, Sistemi mund t'ia zbulojë informacionet tuaja shëndetësore një anëtar të familjes ose një miku i cili është i përfshirë në përkujdesjen tuaj ose në pagesën për përkujdesjen tuaj.

Individët që mund të veprojnë në emrin tuaj. Sistemi mund t'ia zbulojë informacionet tuaja shëndetësore një përfaqësuesi personal, përfshirë një prindi ose kujdestari.

Për të shmangur një kërcënim serioz për shëndetin ose sigurinë. Sistemi mund të përdorë dhe të zbulojë informacionet tuaja personale kur është e nevojshme, për të parandaluar një kërcënim serioz për shëndetin dhe sigurinë tuaj, ose shëndetin dhe sigurinë e publikut ose një personi tjetër.

Ushtarakë dhe veteranë. Nëse jeni anëtar i forcave të armatosura, Sistemi mund t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore siç kërkohet nga autoritetet e komandës ushtarake.

Kompensimi i punëtorëve. Sistemi mund t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore në Bordin e Kompensimit të Punëtorëve ose programe të ngjashme, nëse është e nevojshme.

Aktivitetet e shëndetit publik. Sistemi mund të përdorë dhe t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për qëllime të shëndetit publik, si për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, ose për të marrë raporte për arsye të caktuara mjekësore si lindje, vdekje, abuzim, neglizhencë dhe dhunë në familje.

Aktivitetet e mbikëqyrjes shëndetësore. Sistemi mund të përdorë dhe t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore tek një agjenci për mbikëqyrjen shëndetësore për aktivitetet e autorizuar me ligj, të cilat përfshijnë auditime, hetime dhe inspektime.

Procedurat ligjore. Nëse jeni i përfshirë në një padi ose një mosmarrëveshje juridike, Sistemi mund t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore si përgjigje ndaj një urdhri gjykate ose urdhri administrativ. Sistemi mund të zbulojë gjithashtu informacionet tuaja shëndetësore në përgjigje të një thirrjeje në gjyq, kërkesë për zbulim ose proces tjetër ligjor nga dikush tjetër i përfshirë në një mosmarrëveshje, por vetëm nëse janë bërë përpjekje për t'ju njoftuar për kërkesën ose për të marrë një urdhër që mbron informacionet e kërkuara.

Zbatimi i ligjit. Sistemi mund të përdorë dhe zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për qëllime të zbatimit të ligjit, duke përfshirë si më poshtë: (i) për të identifikuar ose gjetur një të dyshuar, të arratisur, dëshmitar të rëndësishëm ose person të zhdukur; (ii) në rrethana që lidhen me viktimat e një krimi; (iii) në rastin e vdekjeve që besojmë se mund të jenë rezultat i një sjelljeje kriminale; (iv) në rastin e krimeve që ndodhin në një qendër të NYC Health + Hospitals; dhe (v) për të raportuar një krim në rast urgjence, vendndodhjen e krimit ose të viktimave, ose identitetin, përshkrimin ose vendndodhjen e personit që ka kryer krimin.

Vdekje. Sistemi mund të përdorë dhe t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për të njoftuar ose ndihmuar në gjetjen e individëve, nëse ata kanë autoritet ligjor të veprojnë në emrin tuaj, një përfaqësues personal ose ndonjë person tjetër të përfshirë në përkujdesjen tuaj, për vdekjen tuaj, me përjashtim të rastit nëse bërja e kësaj gjëje do të ishte në kundërshtim me çdo preferencë ose udhëzim paraprak që keni shprehur me shkrim.

Mjekët ligjorë, ekzaminuesit mjekësorë, drejtuesit e funeralit dhe dhurimet e organeve. Sistemi mund të përdorë dhe t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore përpara një mjeku ligjor, ekzaminuesi mjekësor ose drejtues funerali, në rast se ato u nevojiten për të kryer detyrën e tyre. Sistemi gjithashtu mund të përdorë dhe të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore me qëllim dhurimin e organeve, syve dhe indeve.

Ndihmave në raste fatkeqësish natyrore. Sistemi mund të përdorë dhe t'i zbulojë informacionet tuaja shëndetësore tek një njësi publike ose privat i autorizuar me ligj ose autoritet tjetër për të ndihmuar në përpjekjet për ndihmë në raste fatkeqësish natyrore, me qëllim koordinimin e njoftimeve për anëtarët e familjes tuaj, të afërmit e tjerë, përfaqësuesit personalë, ose personat e tjerë përgjegjës për kujdesin tuaj.

Aktivitetet e Sigurisë Kombëtare dhe Zbulimit. Sistemi mund t'ua zbulojë informacionet tuaja shëndetësore zyrtarëve të autorizuar Federal për shërbime zbulimi, kundër-zbulimi dhe aktivitete të tjera të sigurisë kombëtare të autorizuar me ligj.

Shërbime mbrojtëse për Presidentin dhe të tjerët. Sistemi mund të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore tek zyrtarët e autorizuar Federale në mënyrë që ata të mund të ofrojnë mbrojtje për Presidentin, persona të tjerë të autorizuar, krerë të huaj të shtetit, ose të kryejnë hetime të veçanta.

Mbrojtjet e veçanta të privatësisë për informacionet për trajtimin e çrregullimeve të përdorimit të substancave (SUD)

Informacionet për trajtimin e çrregullimeve SUD gëzojnë mbrojtje shtesë të privatësisë sipas rregullores Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së, të cilat kufizojnë mënyrën se si Sistemi i përdor ose zbulon informacionet tuaja për trajtimin e çrregullimeve SUD. Nëse nuk nënshkruani një formular pëlqimi, Sistemi mund t'i zbulojë informacionet tuaja për trajtimin e çrregullimeve SUD vetëm në rrethana të kufizuara, siç lejohet nga rregullorja Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së. Sistemi mund të lejohet të përdorë ose zbulojë të dhënat tuaja për trajtimin e çrregullimeve SUD pa pëlqimin tuaj me shkrim në rast të një urgjence mjekësore ose rrethanave të veçanta, siç lejohet nga rregullorja Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së.

Pëlqimi për përdorimet dhe zbulimet. Një pëlqim i vetëm me shkrim mund të përdoret për të gjitha përdorimet dhe zbulimet e ardhshme të informacioneve për trajtimin e çrregullimeve SUD për operacionet e trajtimit, pagesave dhe të kujdesit shëndetësor. Të dhënat për trajtimin e çrregullimeve SUD që i zbulohen një programi të pjesës 2, një entiteti të mbuluar ose një bashkëpunëtori biznesi në përputhje me pëlqimin tuaj për operacionet e trajtimit, pagesave dhe të kujdesit shëndetësor, mund të zbulohen më tej nga ai program i pjesës 2, entiteti i mbuluar ose bashkëpunëtori i biznesit, pa pëlqimin tuaj me shkrim, në masën që një zbulim i tillë lejohet nga rregulloret e ligjit HIPAA.

Përdorimet dhe zbulimet e ndaluara. Sistemi nuk mund të përdorë ose zbulojë informacionet tuaja për trajtimin e çrregullimeve SUD në asnjë procedurë civile, administrative, penale ose legjislative kundër jush pa pëlqimin specifik me shkrim ose një urdhër gjykatë të shoqëruar me një thirrje për gjyq. Informacionet për trajtimin e çrregullimeve SUD do të përdoren ose zbulohen vetëm në bazë të një urdhri gjykatë, pasi ju ose Sistemi të jeni njoftuar dhe t'ju jetë dhënë mundësia për t'u dëgjuar në gjykatë.

Zbulimet për mbledhjen e fondeve. Sistemi mund të përdorë ose të zbulojë të dhënat për trajtimin e çrregullimeve SUD për të mbledhur fonde në dobi të një programi të pjesës 2 vetëm nëse ju është dhënë një mundësi e qartë dhe e dukshme për të vendosur që të mos merrni komunikime për mbledhjen e fondeve. Ju keni të drejtë të zgjidhni që të mos merrni komunikime për mbledhjen e fondeve.

Përdorimet dhe zbulimet e informacioneve për trajtimin e çrregullimeve SUD që nuk përshkruhen në këtë njoftim do të bëhen vetëm me pëlqimin tuaj me shkrim. Përdorimet dhe zbulimet e informacioneve për trajtimin e çrregullimeve SUD mund të bëhen pa pëlqimin me shkrim nëse lejohet sipas rregullores Pjesa 2, titulli 42 i CFR-së.

Të drejtat në lidhje me informacionet tuaja shëndetësore

Ju keni këto të drejta në lidhje me informacionet tuaja shëndetësore që Sistemi i ruan në lidhje me ju:

E drejta për të pasur akses dhe për të kopjuar. Ju keni të drejtë të kërkonit akses dhe të merrni një kopje të informacioneve tuaja shëndetësore, përveç shënimeve të psikoterapisë dhe

informacioneve që kanë të bëjnë me një studim klinik në vazhdim e sipër. Ju keni të drejtë të kërkonti kopje të informacioneve tuaja shëndetësore në formatin që parapëlqeni. Për të kërkuar një kopje të informacioneve tuaja shëndetësore ju lutemi paraqisni kërkesën tuaj me shkrim pranë entitetit ose qendrës përkatëse të Departamentit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor. Sistemi rezervon të drejtën, nën rrethana të kufizuara, të mohojë aksesin në informacionet tuaja shëndetësore, dhe në këtë rast, t'ju sigurojë një shpjegim me shkrim për mohimin, si dhe të drejtën tuaj për të apeluar atë vendim. Sistemi mund të vendosë një tarifë të arsyeshme për të mbuluar kostot e krijimit të kopjeve të shënimeve mjekësore. Sistemi është i detyruar që t'ju njoftojë me shkrim çdo tarifë të parashikuar përpara se t'ju dërgojë informacionin e kërkuar, nëse informacioni i kërkuar shëndetësor do të vonohet për ndonjë arsye, ose nëse informacioni i kërkuar shëndetësor nuk mund të jepet në formatin e kërkuar.

E drejta për të ndryshuar. Nëse mendoni se informacioni juaj shëndetësor që përmbahet në Sistem është i pasaktë ose jo i plotë, ju keni të drejtë të kërkonti që Sistemi të ndryshojë informacionin tuaj shëndetësor për aq kohë sa informacioni mbahet nga Sistemi ose për Sistemin. Për të kërkuar ndryshime në informacionet tuaja shëndetësore, ju lutemi paraqisni kërkesën tuaj me shkrim pranë entitetit ose qendrës përkatëse të Departamentit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor. Ju duhet të paraqisni një arsye për të mbështetur kërkesën tuaj për ndryshim. Në rrethana të veçanta, Sistemi mund ta refuzojë kërkesën tuaj. Nëse kërkesa juaj refuzohet, Sistemi duhet t'ju japë një shpjegim me shkrim mbi arsyet pse u refuzua.

E drejta për të kërkuar shënimet e zbulimit të informacionit. Ju keni të drejtë të kërkonti një "shënimet e zbulimit të informacioneve", në të cilën duhet të renditen mënyrat sesi Sistemi ka zbuluar informacionet tuaja shëndetësore. Lista nuk do të përfshijë zbulime të veçanta si për shembull informacionet e ndara për kurimin tuaj, pagesën ose operacionet shëndetësore, ose zbulimet e kryera me autorizimin tuaj. Për të kërkuar shënimet e zbulimit të informacioneve, ju lutemi paraqisni kërkesën tuaj me shkrim pranë qendrës entitetit ose përkatëse të Departamentit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor. Kërkesa juaj duhet të përfshijë një periudhë kohore të zbulimit së informacioneve shpjeguese që nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë vjet, dhe nuk mund të përfshijë data përpara 14 Prillit 2003. Lista e parë që do të kërkonti brenda një periudhe 12-mujore do të jetë pa pagesë. Për lista të mëtejshme, Sistemi mund t'ju faturojë një tarifë të arsyeshme.

E drejta për të kërkuar kufizime. Ju keni të drejtë të kërkonti kufizim në lidhje me informacionet tuaja shëndetësore që Sistemi përdor ose zbulon për trajtim, pagesën ose operacionet shëndetësore. Ju gjithashtu keni të drejtë të kërkonti kufizime për sa i përket informacioneve tuaja shëndetësore që Sistemi ia zbulojë dikujt tjetër i cili është i përfshirë në përkujdesjen tuaj, si për shembull një anëtar i familjes ose një mik. Për të kërkuar kufizime në informacionet tuaja shëndetësore, ju lutemi paraqisni kërkesën tuaj me shkrim pranë entitetit ose qendrës përkatëse të Departamentit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor, Departamentit të Pranimi ose Regjistrimit. *Sistemi mund edhe të mos jetë dakord me kërkesën tuaj për kufizim.* Megjithatë, nëse bihet dakord, Sistemi do të respektojë kërkesën tuaj, përveç rastit kur informacioni shëndetësor është i nevojshëm për t'ju siguruar trajtim urgjent.

E drejta për të kërkuar mënyra alternative komunikimi. Ju keni të drejtë të kërkonti që Sistemi të komunikojë me ju në lidhje me çështjet mjekësore ose informacionet tuaja shëndetësore në një mënyrë ose vendndodhje alternative. Për të kërkuar metoda alternative komunikimi, ju lutemi paraqisni kërkesën tuaj me shkrim pranë entitetit ose qendrës përkatëse të Departamentit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor. Kërkesa juaj duhet të saktësojë mënyrën sesi dëshironi të kontaktoheni. Sistemi nuk do t'ju kërkojë arsyen pse po e bëni këtë kërkesë, dhe do të plotësojë të gjitha kërkesat e arsyeshme.

E drejta për t'u njoftuar në rast shkeljeje. Ju keni të drejtë të njoftoheni kur informacionet tuaja shëndetësore janë përvetësuar, parë, përdorur ose zbuluar në mënyrë të paligjshme dhe në ato

raste kur Sistemi përcakton që informacionet tuaja shëndetësore me shumë mundësi janë komprometuar (referuar si "shkelje"). Nëse ndodh një shkelje e informacioneve tuaja shëndetësore, ju do të njoftoheni për shkeljen me shkrim, brenda 60 ditëve nga momenti i zbulimit të shkeljes.

E drejta për të pasur një kopje me shkrim të këtij NPP. Ju keni të drejtë të pajiseni me një kopje të këtij NPP në çdo lloj momenti. Ju mund të kërkonti një kopje të këtij njoftimi NPP duke vizituar faqen e internetit të NYC Health + Hospitals në <https://www.nychealthandhospitals.org/> ose duke kontaktuar me entitetin ose qendrën përkatëse të Departamentit të Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor, Departamentit të Pranimi ose Regjistrimit.

E drejta për të tërhequr autorizimin. Nëse ju i jepni Sistemit autorizimin për të përdorur ose zbuluar informacionet tuaja shëndetësore, ju mund ta tërhiqni këtë autorizim, me shkrim, në çdo kohë. Nëse e tërhiqni autorizimin tuaj, Sistemi nuk do të përdorë ose të zbulojë informacionet tuaja shëndetësore për arsye të përfshira në autorizimin tuaj me shkrim. Sistemi nuk është në gjendje të tërheqë shpërndarjen e kaluar të informacionit të kryera me autorizimin tuaj.

Ankesa. Nëse besoni se të drejtat tuaja të privatësisë janë shkelur, se informacionet tuaja shëndetësore (duke përfshirë informacionet tuaja për trajtimin e çrregullimeve SUD) janë aksesuar, përdorur ose zbuluar në mënyrë të papërshtatshme ose nëse keni shqetësime në lidhje me praktikën e privatësisë së Sistemit, kontaktoni me Zyrën e Pajtuëshmërisë të Korporatës, Përgjegjësin për Privatësinë dhe Sigurinë e Korporatës me email në adresën CPO@nychhc.org, ose në mënyrë anonime dhe konfidenciale, nëpërmjet Linjës telefonike pa pagesë të ndihmës për pajtuëshmërinë të Sistemit në numrin 1-866-HELP-HHC (1-866-435-7442). Ju keni gjithashtu të drejtën të kryeni një ankesë edhe pranë Sekretarit të Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore. *Ju nuk do të penalizoheni nëse paraqisni një ankesë.*

Të drejta shtesë në lidhje me informacionet për trajtimin e çrregullimeve SUD:

Në lidhje me informacionet tuaja për trajtimin e çrregullimeve SUD, ju keni të drejtë që:

- Të kërkonti kufizime të zbulimeve të bëra me pëlqimin paraprak për qëllime të operacioneve të trajtimit, pagesave dhe të kujdesit shëndetësor.
- E drejta për të kërkuar dhe marrë kufizime se çfarë të dhënash mjekësore mund t'i zbulohen planit tuaj shëndetësor për shërbimet për të cilat keni paguar plotësisht, në të njëjtën mënyrë siç zbatohet ligji HIPAA për zbulimin e informacioneve të mbrojtura shëndetësore.
- E drejta për shënimet e zbulimit të informacionit në lidhje me kartelat mjekësore elektronike për 3 vitet e fundit dhe e drejta për shënimet e zbulimit të informacionit që përmbush kërkesat e ligjit HIPAA për të gjitha zbulimet e tjera të bëra me pëlqim.
- E drejta për një listë të zbulimeve nga një ndërmjetës për 3 vitet e fundit.